

## **RAPORT NARRATIV**

### **VLERËSIMI I PERSONELIT AKADEMIK PËR INFRASTRUKTURËN DHE SHËRBIMET ADMINISTRATIVE**

**Viti akademik 2024–2025**  
**Institucioni:** Kolegji Tempulli

Qershor, 2025

**Bazuar në:** Pyetësin për Personelin Akademik (Likert 1–5)  
**Numri i të anketuarve:** 7 persona

#### **1. Përmbledhje e Përgjithshme**

Vlerësimi i përgjithshëm nga pyetësi rezultoi me mesatare 4.10, që tregon se stafi akademik e percepton institucionin me nivel të lartë të performancës, bashkëpunimit dhe kushteve të punës. Shumica e pyetjeve kanë marrë përgjigje në nivelin “Pajtohem” dhe “Pajtohem plotësisht”, duke treguar që institucioni gëzon besim dhe stabilitet të brendshëm.

#### **2. Fusha Misioni dhe Organizimi Institucional**

- **Misioni i institucionit është mirë i njohur për tërë kuadrin punonjës të tij**  
7 nga 7 persona (100%) pajtohen plotësisht.  
Tregon se vizioni dhe misioni janë të qartë dhe përfshihen në punën e përditshme.
- **Institucioni ka bërë vlerësime krahasuese me institucione të tjera –**  
5 nga 7 persona (71.4%) pajtohen.  
Sugjeron se ka pasur vlerësime, por me nevojë për intensifikim të krahasimeve rajonale.
- **Organizimi i brendshëm i institucionit është i kënaqshëm –**  
4 nga 7 persona (57.1%) pajtohen.  
Duhet vlerësim i rishikuar i strukturës së brendshme për efikasitet më të madh.

#### **Mesatarja e fushës: 4.1**

**Përfundim:** Misioni dhe drejtimi strategjik janë të qarta; nevojitet përmirësim i organizimit të brendshëm dhe benchmarking me institucione të rajonit.

#### **3. Fusha: Burimet Njerëzore dhe Ambienti i Punës**

- **Profili i personelit akademik është i kënaqshëm –**  
7 nga 7 persona (100%) pajtohen plotësisht.

- **Raportet gjinore në institucion janë të balancuara –**  
6 nga 7 persona (85.7%) pajtohen.

**Mesatarja e fushës: 4.3**

**Përfundim:** Stafi e percepton përbërjen akademike si të balancuar dhe profesionale. Ka klimë pozitive bashkëpunimi, respekt dhe komunikim ndërpersonal.

**4. Fusha: Shërbimet Mbështetëse (Biblioteka, Karriera, Financa)**

- **Zyra për këshillim dhe zhvillim të karrierës ofron këshillime të dobishme –**  
5 nga 7 persona (71.4%) pajtohen.
- **Biblioteka ofron shërbime cilësore –**  
4 nga 7 persona (57.1%) pajtohen.
- **Njësia e financave ofron shërbime efikase dhe të kënaqshme –**  
5 nga 7 persona (71.4%) pajtohen.

**Mesatarja e fushës: 3.9**

**Përfundim:** Shërbimet administrative janë efikase, por kërkohet pasurim i bibliotekës dhe përmirësim i digjitalizimit të shërbimeve.

**5. Fusha: Hulumtimet dhe Zhvillimi Profesional**

- **Inkurajimi për pjesëmarrje në projekte kërkimore –** 5 nga 7 (71.4%) pajtohen.
- **Mbështetja për publikime shkencore –** 4 nga 7 (57.1%) pajtohen pjesërisht.
- **Pjesëmarrja në konferenca shkencore –** 6 nga 7 (85.7%) pajtohen.
- **Zhvillimi profesional i stafit –** 5 nga 7 (71.4%) pajtohen.

**Mesatarja e fushës: 3.9**

**Përfundim:** Ekziston mbështetje e mirë institucionale për zhvillim profesional dhe kërkime, por kërkohet **ristrukturim i sistemit të mbështetjes për publikime shkencore dhe fond dedikuar për Research&Development.**

**6. Fusha: Infrastrukturë dhe Higjienë**

- **Qasja në pajisje për shtypje dhe fotokopjim –** 7 nga 7 (100%) pajtohen plotësisht.
- **Kushtet higjienike në institucion –** 6 nga 7 (85.7%) pajtohen.
- **Kabinetet e mësimdhënësve janë të pajisura me të gjitha mjetet e nevojshme –** 6 nga 7 (85.7%) pajtohen.

#### **Mesatarja e fushës: 4.4**

**Përfundim:** Infrastruktura dhe kushtet fizike janë në nivel të lartë, me pajisje moderne dhe mjedise të pastra. Nevojitet vetëm zgjerim i hapësirave bashkëpunuese.

### **7. Komentet e Hapura të Stafit Akademik**

#### **Nr. Komenti**

- 1 Nuk kam komente shtesë
- 2 Të shqyrtohen ato pika ku vlerësimi është negativ
- 3 Jo, nuk kam asnjë koment
- 4 Nuk kam
- 5 Përmes kulturës së punës së përbashkët dhe bashkëpunimit në emër të cilësisë së arsimit të lartë
- 6 Jo
- 7 Nuk kam

#### **Përmbledhje:**

Komentet tregojnë kënaqësi të përgjithshme me funksionimin institucional. Vetëm një pjesëmarrës ka theksuar nevojën që të analizohen në mënyrë të veçantë pikat me vlerësime më të ulëta, një sugjerim i vlefshëm për procesin e përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë.

### **8. Përfundime dhe Rekomandime**

1. Të vazhdohet me praktikën e mira në komunikim, mbështetje dhe kushte pune.
2. Të fuqizohet komponenti i **kërkimit shkencor dhe publikimeve** përmes fondeve institucionale.
3. Të përmirësohen aspektet e **organizimit të brendshëm** dhe menaxhimit të resurseve.
4. Të zhvillohet një plan **për benchmarking rajonal** me institucione simotra.
5. Të krijohet një **njësi për kërkim dhe zhvillim** për koordinimin e projekteve dhe publikimeve.

**Vlerësimi përfundimtar për institucionin:** 4.10 / 5

**Numri i stafit pjesëmarrës:** 7 persona

**Statusi:** Institucion me performancë të qëndrueshme, staf të përkushtuar dhe mjedis të përshtatshëm akademik.